



LETËR E HAPUR

REFORMA E RE TERRITORIALE RREZIKON PËRFAQËSIMIN LOKAL

Në emër të Diasporës Shqiptare të Bashkuar, kërkojmë tërheqjen e propozimit për reformën territoriale dhe hapjen e një procesi të gjerë, transparent dhe gjithëpërfshirës konsultimi me qytetarët.

**SEPSE IDENTITETI LOKAL, PËRFAQËSIMI DHE
ZËRI I KOMUNITETEVE DUHET TË MBROHEN!**





Ne, Diaspora Shqiptare e Bashkuar (UDA), e përbërë nga aktivistë apartiakë nga 22 shtete të botës, kemi ndjekur me vëmendje propozimet e mazhorancës qeverisëse lidhur me reformën e re territoriale, e cila parashikon uljen e numrit të bashkive nga 61 në 46, duke sjellë për pasojë bashkimin e 15 qyteteve dhe njësisë vendore me bashki më të mëdha.

Duke marrë parasysh lidhjet tona të forta me Shqipërinë dhe me zonat që preken drejtpërdrejt nga kjo reformë, kundërshtojmë kategorikisht këtë propozim për arsyet e mëposhtme:

1 Bashkitë më të mëdha nuk garantojnë automatikisht shërbime më cilësore dhe zhvillim më të madh për qytetarët.

Përvoja e reformës territoriale të vitit 2014 ka treguar se në shumë raste zona të tëra kanë mbetur pa investimet e nevojshme, me mungesa në shërbimet bazë dhe, si rezultat, kanë përjetuar rënie të popullsisë dhe emigrim të vazhdueshëm.

2 Përqendrimi i mëtejshëm i pushtetit në nivel qendror do të dobësojë përfaqësimin lokal.

Ky proces rrezikon të zvogëlojë ndikimin e komuniteteve më të vogla në vendimmarrje, duke bërë që nevojat dhe interesat e qytetarëve të këtyre zonave të kenë më pak peshë në politikatat publike dhe në shpërndarjen e burimeve.

3 Reforma sjell rrezik për humbjen e identitetit lokal.

Banorët e këtyre zonave, shumë prej të cilëve janë pjesë e diasporës shqiptare dhe vazhdojnë të ruajnë lidhje të forta me vendlindjen, janë të lidhur ngushtë me historinë, traditat dhe trashëgiminë kulturore të komuniteteve të tyre. Bashkimi me bashki më të mëdha mund të çojë në zbehjen e këtij identiteti të veçantë lokal.

4 Motive politike pas kësaj ndarjeje të re territoriale.

Procesi i konsultimit publik deri më tani ka qenë i pamjaftueshëm dhe jo transparent. Kemi konstatuar se diskutimet janë zhvilluar kryesisht në nivele partiake, ndërsa zëri i banorëve që preken drejtpërdrejt nga kjo reformë nuk është dëgjuar në mënyrën e duhur.

Shqetësimi ynë kryesor lidhet me faktin se bashkitë dhe qytetet si Rrogozhina, Fushë-Arrëzi, Poliçani, Dimali, Prrenjasi, Belshi, Cërriku, Patosi, Divjaka, Klosi, Memaliaj, Këlcyra, Libohova, Selenica dhe Maliqi rrezikojnë të humbasin zërin, identitetin dhe ndikimin e tyre në nivel lokal.

Ne i bashkohemi protestave legjitime të banorëve të këtyre zonave dhe i bëjmë thirrje mazhorancës qeverisëse që të tërhiqet menjëherë nga ky propozim dhe të hapë një proces të gjerë, transparent dhe gjithëpërfshirës konsultimi me qytetarët dhe komunitetet e prekura.